



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

Tiranë, më 25.04.2018

NJOFTIM PËR MEDIAT

Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin nr. 475, datë 21.09.2017 mbi “Mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”, vendosi dhënien e rekomandimeve për operatorët e tregut të telefonisë celulare.

Në zbatim të këtyre rekomandimeve, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në datë 26.03.2018 nxori Urdhrin me nr. 64, “Për vlerësimin e ndryshimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 30 në 28 ditë”.

Vendimi i datës 26.03.2018 rikthen kohëzgjatjen e vlefshmërisë së paketave me parapagim nga 28 ditë në 30 ditë.

Autoriteti i Konkurrencës e vlerëson shumë të rëndësishëm zbatimin e rekomandimit nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare por edhe bashkëpunimin ndërinstytucional, falë të cilit u bë e mundur rikthimi i paketave 30 ditore, në përfitim të konsumatorëve të tregut të telefonisë celulare dhe zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës dhe masat rregullatore të ndërmarra nga AKEP, sigurojnë jo vetëm zbatimin e ligjit por dhe një konkurrencë të lirë dhe efektive nga ndërmarrjet që operojnë në tregun e telefonisë celulare.

Autoriteti i Konkurrencës do të vijojë monitorimin e ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Autoriteti i Konkurrencës